



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Adresa: Bulevardi "Zogu I", Godina 57/2, Nr.18 Tirane

Tel/Fax 04 2226814 ; 2226814

Nr. 383/1 Prot.

Tiranë, më 13.07.2015

V E N D I M

Nr. 69, datë 13.07.2015

**Mbi përfundimin e procedimit administrativ,  
filluar me urdhrin e verifikimit nr. 383/1, dt. 18.06.2015**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15 të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar; neneve 80-104 të ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", si dhe Rregullores "Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit", miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2013, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorisë së Inspektimit dhe Hetimit Administrativ, në lidhje me procedurën e verifikimit të kryer në Ministrinë e Drejtësisë për rastin e nëpunëses \*\*\*\*\* ,

**VËREJ SE:**

Në zbatim të urdhrin të verifikimit nr. 383/1 prot., datë 18.06.2015, është nisur verifikimi i procedurës së lëvizjes paralele për punonjësen e Ministrisë së Drejtësisë, \*\*\*\*\* .

Nga shqyrtimi i akteve të dërguara me shkresën nr. 4313/1 prot., dt. 26.06.2015 rezulton se marrëdhënia e punës së punonjëses \*\*\*\*\* pranë Ministrisë së Drejtësisë ka filluar në datën 15.09.2008 në pozicionin e "Përgjegjëses në Sektorin e Arkivit të Gjyqësorit në Drejtorinë e Informatizimit të të Dhënave, Statistikës dhe Bibliografisë".

Pas kryerjes së procedurës së konkurimit, me aktin nr.4324/7, dt. 16.2.2009, është emëruar nga Departamenti i Administratës Publike, nëpunëse civile në pozicionin e "Përgjegjëses së Sektorit të Arkivit të Gjyqësorit në Drejtorinë e Informatizimit të të Dhënave, Statistikës dhe Bibliografisë". Ka vijuar në këtë detyrë deri në muajin Janar të vitit 2012, kur për shkak të ristrukturimit, me aktin nr. 14/43 prot., dt.17.01.2012, është sistemuar në pozicionin "Inspektore në Drejtorinë e Auditimit të Brendshëm". Më tej, po për shkak të ristrukturimit dhe riorganizimit të pozicioneve të punës, me aktin nr. 1487/55, dt. 26.11.2013, të Departamentit të Administratës Publike, u ripozicionua në pozicionin "Specialiste në Drejtorinë e Auditimit të Brendshëm", ku vijon të punojë deri më sot.

Rezulton gjithashtu, se kjo punonjëse disponon edhe certifikatën nr. 1746 rregj. "Auditues i Brendshëm në Sektorin Publik", kusht i domosdoshëm për të kryer detyrën e audituesit të brendshëm.

Nga dokumentacioni i administruar vërehet se kjo punonjëse edhe pse ka filluar punë me akt emërimi, ka marrë pjesë në procedurat e konkurimit të parashikuara për pranimin në shërbimin civil nga ligji i kohës nr. 8549, dt. 11.11.1999, "Statusi i nëpunësit civil". Gjatë kryerjes së periudhës së provës, në datat 05 deri 20 Tetor 2009, ka kryer trajnimin e detyrueshëm për nëpunësit civil në periudhë prove, organizuar nga Instituti i Trajnimit të Administratës Publike. Veç kësaj, lëvizjet e mëvonshme, në pozicione të ndryshme për shkak ristrukturimi, janë kryer sipas procedurave të rregullta ligjore, nëpërmjet Departamentit të Administratës Publike.

Dita e fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", e ka gjetur këtë punonjëse në punë prej më shumë se një viti, në pozicionin "Specialiste në Drejtorinë e Auditimit të Brendshëm" dhe për shkak të veprimit të nenit 67, pika 3, të ligjit në fjalë, i cili parashikon shprehimisht se "Nëpunësit civilë ekzistues, punonjësit ekzistues, që janë të punësuar në pozicione të shërbimit civil, sipas këtij ligji dhe që janë rekrutuar sipas një procedure pranimi konkurruese, të ngjashme me atë të përcaktuar nga ligji nr. 8549, datë 11.11.1999 "Statusi i nëpunësit civil", apo që janë të punësuar në të njëjtin vend pune për një periudhë jo më të vogël se 1 vit, janë, për shkak të ligjit, nëpunës civilë", është nëpunëse civile në këtë pozicion.

Bazuar në sa më sipër, informacioni i paraqitur pranë Komisionerit, në përmbajtjen e të cilit ngrihen pretendime për shkelje të kryera apo lejuara nga njësia e burimeve njerëzore dhe Departamenti i Administratës Publike në trajtimin e rastit të emërimit të nëpunëses \*\*\*\*\* rezulton i pasaktë.

#### **Për këto arsye:**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të përcaktuara në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15 të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, si dhe në nenin 16 dhe 34 të Rregullores "Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit", miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2013, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

#### **V E N D O S A:**

1. Përfundimin e procedimit administrativ të iniciuar me urdhrin e verifikimit nr. 383/1 prot., datë 18.06.2015, "Mbi verifikimin e procedurës së lëvizjes paralele për punonjësen e Ministrisë së Drejtësisë \*\*\*\*\*".
2. Të njoftohen për këtë vendim, Departamenti i Administratës Publike, Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Drejtësisë \*\*\*\*\*.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

#### **KOMISIONERI**

**Pranvera STRAKOSHA**